



ZP.Anr. 3/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Bujar Muzaqi kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Hajriz Hoti, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Stranka Demokratske Akcije- SDA me seli Komuna Pejë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), nr. 01/796-2026 të datës 14.05.2026, lidhur me refuzimin për certifikim për pjesëmarrje në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen me date 07 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur me datë 16.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ANKESA ZP.Anr.3/2026, e datës 15.05.2026, e subjektit politik Stranka Demokratske Akcije-SDA me seli në Komuna Pejë, e parashtruar kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), nr. 01/796-2026 të datës 14.05.2026, lidhur me refuzimin për certifikim për pjesëmarrje në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen me date 07 Qershor 2026.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesën ZP.Anr.3/2026, me datën 15.05.2026, nga subjekti politik Stranka Demokratske Akcije-SDA, në të cilën theksohet se SDA si parti e regjistruar ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin për Zgjedhjet Parlamentare të datës 07.06.2006 tek Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontroll Financiar brenda afatit të paraparë dhe se të dhënat për regjistrimin e SDA-së dhe kandidatëve të partisë që janë kërkuar, janë dorëzuar përmes platformës tek Zyra për Regjistrim brenda afatit të paraparë në orën 23:52, më 12.05.2026.

Më tej në ankesë theksohet se më datë 13.05.26, Zyra për Regjistrim i është përgjigjur SDA-së që të bëjë plotësimin e të dhënave të kërkuara dhe numrin shtesë të nënshkrimeve të përkrahësve të partisë brenda po asaj dite deri në orën 18:00, megjithëse SDA kishte dorëzuar më shumë se 1000 nënshkrime të kërkuara. Stranka Demokratske Akcije (SDA) ka plotësuar të dhënat e nevojshme për kryetarin dhe personin kontaktues, si dhe kandidatët dhe pjesën tjetër, dhe së bashku me numrin e kërkuar të nënshkrimeve ia ka dorëzuar KQZ-së brenda afatit të paraparë. Megjithëse SDA dërgoi numër të mjaftueshëm nënshkrimesh, Zyra e KQZ-së kërkoi 500 nënshkrime shtesë pavarësisht se SDA kishte dërguar më shumë se 1.200 nënshkrime.

Zyra, në email-in e dërguar më 13.05.2026 në mbrëmje, kërkoi 500 nënshkrime shtesë, gjë që ishte plotësisht e panevojshme, dhe dha afat deri në orën 14:00 të ditës së nesërme, që është

afat shumë i shkurtër për një punë kaq të madhe të marrjes së të dhënave të 500 personave. Pavarësisht kësaj, SDA ka mbledhur 550 nënshkrime të përkrahësve dhe ia ka dërguar Zyrrës së KQZ-së në orën 13:45, më 14.05.2026.

Megjithatë, KQZ në mbledhjen e tij të mbajtur më 14.06.2026 mori një vendim të padrejtë që kërkesa e SDA-së për regjistrim për zgjedhjet parlamentare të refuzohet, me arsyetimin se SDA nuk ka ndërmarrë asnjë masë për të dorëzuar nënshkrimet deri në orën 14:00, pavarësisht se personi kontaktues i SDA-së dërgoi 550 nënshkrime shtesë në orën 13:45.

Parashtruesi i ankesës, ankesën e tij e paraqet kundër vendimit për certifikim të KQZ-së, duke pasur parasysh se Subjekti Politik SDA është parti që ekziston në Kosovë prej 36 vjetësh, dhe se kërkojnë që të certifikohen edhe për këto zgjedhje.

Si provë kanë bashkangjitur: email-i nga Zyra e KQZ-së dhe email-i i personit kontaktues të SDA-së, listat me nënshkrimet që i janë dërguar dhe Vendimi i KQZ-së për refuzimin e konfirmimit të regjistrimit për zgjedhje.

Në përgjigjen në ankesë KQZ-ja, sqaron se periudha e aplikimit për certifikimin e subjekteve politike për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat mbahen më 07.06.2026, ka filluar më 2 Maj 2026 dhe ka përfunduar më 10 maj 2026 në orën 24:00. Duke pasur parasysh që procesi zgjedhor i jashtëzakonshëm realizohet me afate të shkurtuara, afati për certifikim sipas Planit Operacional ka qenë i hapur për nëntë (9) ditë.

Duke qenë se afati ka përfunduar më 10 Maj në ora 24:00, Zyra ka filluar verifikimin e aplikimeve për certifikimin menjëherë më datë 11 Maj 2026. Partia politike Stranka Demokratske Akcije është parti politike e regjistruar nga data 21.08.2000 andaj në përputhje me paragrafin 3 të nenit 16, kjo parti është konsideruar automatikisht e certifikuar pasi ka konfirmuar pjesëmarrjen në zgjedhje brenda afatit të përcaktuar me Planin Operacional.

Më tej në përgjigje KQZ thekson se subjektet politike duhet të plotësojnë të gjitha kushtet e parapara me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregulloren Zgjedhore Nr. 04/ 2024 Certifikimi i Subjekteve Politike dhe i Kandidatëve të tyre në mënyrë që të certifikohen kandidatët e kësaj partie për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më 7 Qershor 2026.

Sipas paragrafit 7 të nenit 2 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/ 2024 Certifikimi i Subjekteve Politike dhe i Kandidatëve të tyre, subjektet politike që aplikojnë për certifikim, obligohen ta dorëzojnë listën e mbështetësve me së paku njëmijë (1,000) nënshkrime.

Duke qenë se SDA, nuk është parti parlamentare, ka qenë e obliguar që në përkrahje të procesit të certifikimit të dorëzojë njëmijë (1.000) nënshkrime në mbështetje të certifikimit.

Të gjitha subjektet politike kanë qenë të obliguar ta plotësojnë listën (librezën) e nënshkrimeve të mbështetësve, e cila përmban: Emrin dhe mbiemrin, datën e lindjes, adresën e banimit, numrin e telefonit, numrin personal të identifikimit dhe nënshkrimin.

Si pjesë e shqyrtimit të aplikimit për certifikim, Zyra e rishikon secilën broshurë me nënshkrime të dorëzuar në mbështetje të aplikimit për certifikim për të siguruar se nënshkrimet janë të vlefshme.

Llojet e nënshkrimeve në vijim konsiderohen si të pavlefshme dhe nuk llogariten ndaj kërkesës së nënshkrimeve: nënshkrimet e personave të cilët nuk janë votues të regjistruar, nënshkrimet e mbështetjes për të cilat çfarëdo informate e kërkuar mungon apo është e pa

lexueshme; nënshkrimet të cilat janë me të njëjtin dorëshkrim si nënshkrimet tjera, përfshirë nënshkrimet nga udhëheqësi i familjes për anëtarët e tjerë të familjes dhe nënshkrimet të cilat përfshijnë informata të cilat nuk përputhen me informatat e regjistruara në variantin më të fundit të listës së votuesve.

Platforma elektronike për aplikim për certifikim në mënyrë automatike verifikon çdo mbështetës të futur në platformë duke e krahasuar me ekstraktin e listës votuese. Cilido mbështetës që nuk gjendet në listën votuese refuzohet nga platforma, duke plotësuar në këtë mënyrë kushtin që secili mbështetës të jetë votues i regjistruar në Republikën e Kosovës.

Zyra kontrollon secilën broshurë të nënshkrimeve për të vërtetuar që fillimisht është dorëzuar numri i duhur i nënshkrimeve. Më tutje verifikimet bëhen për të kontrolluar nëse nënshkrimet e dorëzuara janë valide, sipas kërkesave ligjore. Këto verifikime bëhen duke kontrolluar nëse janë përfshirë të gjitha informatat e kërkuara në broshurën e nënshkrimeve.

Më tutje Zyra kontakton me mbështetësit për të verifikuar nëse ata kanë dhënë nënshkrimin e tyre personalisht dhe se janë informuar nga mbledhësi i nënshkrimeve për arsyen e mbledhjes së nënshkrimeve.

Ky subjekt politik ka dorëzuar listën e mbështetësve me gjithsejtë 653 nënshkrime, të cilat janë validuar në platformë dhe konfirmohet se janë votues në listën preliminare të votuesve.

Siç u theksua më lartë, verifikimi i aplikimit për certifikim ka filluar menjëherë me datën 11 maj dhe Zyra menjëherë ka vërejtur që në broshurën e nënshkrimeve të përkrahjes të subjektit politik Stranka Demokratske Akcije, ka vetëm 653 nënshkrime të validuara në platformën elektronike të certifikimit ndërsa në broshurën fizike të ngarkuar ishin vetëm 492 nënshkrime.

Zyra me datën 13.05.2026 i ka dërguar e-mail dhe ka komunikuar më partinë politike për qëllime të dërgimit të nënshkrimeve shtesë (500 nënshkrime) duke i dhënë afat deri me datën 14.05.2026, në orën 14:00.

Në mënyrë që të konsiderohet i përmbushur kushti i dorëzimit të nënshkrimeve të mbështetësve në platformë duhet të ngarkohen formularët zyrtar të mbledhjes së nënshkrimeve të skanuara me të gjitha të dhënat e kërkuara si dhe forma elektronike që duhet të validohet nga sistemi i cili bën krahasimin me ekstraktin e listës votuese për të vërtetuar që mbështetësit janë votues të regjistruar në Republikën e Kosovës.

Kërkesa për ngarkim të formularëve zyrtar të skanuar të plotësuar me të gjitha të dhënat bëhet për tu vërtetuar që mbështetësit kanë dhënë mbështetjen e tyre duke u nënshkruar në formular. Ndërsa kërkesa për formën elektronike bëhet për të krahasuar numrat personal të mbështetësve me listën votuese duke e verifikuar që mbështetësit janë votues të regjistruar në Republikën e Kosovës si dhe që në listën e mbështetësve nuk ka duplikime dhe në listë në total janë 1,000 mbështetës valid. Forma elektronike kërkohet gjithashtu për të krijuar databazën e mbështetësve, të cilët Zyrja tutje i verifikon nëse janë mbështetës të subjekteve tjera e që sipas paragrafit 8 të nenit 2 Rregullores Zgjedhore Nr. 04/ 2024 Certifikimi i Subjekteve Politike dhe i Kandidatëve të tyre, personi mund të jap nënshkrimin e tij në mbështetje të vetëm një subjekti politik për ato Zgjedhje.

Subjekti politik edhe pas afatit të caktuar me kërkesën e Zyrës për nënshkrime shtesë të dërguar përmes emailit të theksuar më lartë, nuk i është përgjigjur kërkesës së Zyrës për nënshkrime shtesë duke përcjellur të gjithë hapat e definuar në platformë. Mbështetës të validuar në formën elektronike kanë mbetur vetëm 653.

Ndërkohë pavarësisht që Zyra në platformë ka vënë në dispozicion formularin zyrtar të mbledhjes së nënshkrimeve si dhe i njëjti i është dërguar partisë politike Stranka Demokratske Akcije përmes emailit, kjo parti politike në platformë ka ngarkuar në formularët e skanuar me një total 1,181 nënshkrime të mbështetësve mirëpo prej tyre 233 nënshkrime nuk janë mbledhur me formularët zyrtar të mbledhjes së nënshkrimeve që nënkupton këto nënshkrime të mbështetjes janë anuluar automatikisht dhe nënshkrime të ngarkuara në formë fizike në total kanë mbetur 930 nënshkrime.

Afatet e shkurtuara janë si rezultat i procesit të jashtëzakonshëm zgjedhor. Afatet për secilin aktivitet përcaktohen menjëherë pas shpalljes së zgjedhjeve përmes Planit Operacional të aprovuar nga KQZ. Siç u theksua më lartë, subjektet politike kanë pasur nëntë ditë për të aplikuar, nga 2 deri më 10 Maj 2026. Gjatë kësaj kohe subjekti politik ka mbledhur nënshkrimet e përkrahjes me formularin e përcaktuar me Rregulloren Zgjedhore Nr. 04/ 2024 Certifikimi i Subjekteve Politike dhe i Kandidatëve të tyre ku përcaktohet qartë çfarë të dhëna duhet të mblidhen nga mbështetësit e procesit të certifikimit për subjektin politik në fjalë.

Afati i certifikimi lidhet ngushtë me aktivitetet e tjera të procesit zgjedhor të cilat janë qenësore për këtë proces. Me datën 16 Maj 2026 sipas Planit Operacional duhet të organizohet shorti i tërheqjes së numrave të subjekteve politike që do të marrin pjesë në Zgjedhje të cilat përcaktojnë përmbajtjen dhe dizajnin e fletëvotimit i cili është i domosdoshëm për fillimin e votimit përmes postës.

Nisur nga sa u tha më lartë, Zyra ka rekomanduar KQZ për refuzimin e aplikimit për certifikim të subjektit politik Stranka Demokratske Akcije, siç parashihet në paragrafin 4 të nenit 17 të LZP.

Rekomandimi i Zyrës është aprovuar nga KQZ në takimin nr. 47 të datës 14 Maj 2026 dhe është marrë vendimi 01/795-2026 për refuzimin e certifikimit të subjektit politik Stranka Demokratske Akcije.

PZAP-i, pasi bëri vlerësimin e deklarimeve të palëve, përgjigjes në ankesë, dhe duke u mbështetur në dispozitat e nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, gjeti se :

-Ankesa është e pa bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, dhe përgjigjes në ankesë të parashtruar nga KQZ-ja, vlerësoj se pretendimet e palës ankuese janë të pa qëndrueshme, dhe si të tilla i refuzoj si të pabazuara, për faktin se parashtruesi i ankesës në Zyrën për Regjistrim, Certifikim dhe Kontroll Financiar ka dorëzuar listën e mbështetësve me gjithsejtë 1,181 nënshkrime, ndërsa Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontroll Financiar nga verifikimet e bëra lidhur me aplikimin për certifikim ka konstatuar se 233 nënshkrime nuk janë mbledhur me formularët zyrtar të mbledhjes së nënshkrimeve që nënkupton këto nënshkrime të mbështetjes së subjektit politik në fjalë janë anuluar automatikisht, dhe nënshkrime të ngarkuara në formë fizike në total kanë mbetur 930 nënshkrime të cilat nënshkrime nuk janë të mjaftueshme për certifikimin e subjektit politik për të marrë pjesë në zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen me date 07 Qershor 2026.

Mbi këtë bazë Paneli konstaton se KQZ-ja, me rastin e marrjes së vendimit drejt vendosur, pasi që subjekti politik SDA nuk i ka përmbushur kriteret e kërkuara sipas nenit 17 të LZP, dhe nenit 2 paragrafi 7 nëparagrafi 7.1, dhe 7.2, si dhe nenit 4 paragrafi 2.2 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2024 Certifikimi i Subjekteve Politike dhe i Kandidatëve të tyre, ku

subjektet politike që aplikojnë për certifikim, obligohen ta dorëzojnë listën e mbështetësve me së paku njëmijë (1,000) nënshkrime.

Pretendimi ankimor se Stranka Demokratske Akcije (SDA) ka plotësuar të dhënat e nevojshme për kryetarin dhe personin kontaktues, si dhe kandidatët dhe pjesën tjetër, dhe së bashku me numrin e kërkuar të nënshkrimeve ia ka dorëzuar KQZ-së brenda afatit të paraparë, ky pretendim ankimor është i pa bazuar, pasi që Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike - KQZ, në platformë ka vënë në dispozicion formularin zyrtar të mbledhjes së nënshkrimeve si dhe i njëjti i është dërguar partisë politike Stranka Demokratske Akcije përmes emailit, kjo parti politike në platformë ka ngarkuar në formularët e skanuar me një total 1,181 nënshkrime të mbështetësve mirëpo prej tyre 233 nënshkrime nuk janë mbledhur me formularët zyrtar të mbledhjes së nënshkrimeve që nënkupton këto nënshkrime të mbështetjes janë anuluar automatikisht dhe nënshkrime të ngarkuara në formë fizike në total kanë mbetur 930 nënshkrime, ndërsa ankuesi nuk ka bashkangjitur prova materiale në ankesë se i ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore të kërkuara bazuar në nenin 2.7, si dhe nenit 4.2.2 të Rregullores zgjedhore nr. 04/2024 certifikimi i subjekteve politike dhe i kandidatëve të tyre, si dhe kushtet ligjore të rregulluara me nenin 23 par.1 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Në bazë të nenit 23 par.1 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës në mënyrë decidive thuhet se *“Si pjesë e shqyrtimit sipas nenit 17 paragrafi 1 të këtij ligji, Zyra e rishikon secilën broshurë me nënshkrime të dorëzuar në mbështetje të aplikimit për certifikim për të siguruar se nënshkrimet janë të vlefshme”*.

Ndërsa në nenin 23 par.2 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës në mënyrë decidive thuhet se *“Në vërtetimin e nënshkrimeve të mbështetjes, Zyra e rishikon secilën broshurë të nënshkrimeve të dorëzuar nga aplikuesit siç përcaktohet me rregullat e KQZ-së.”*

Në nenin 2 paragrafi 7 nëparagrafi 7.1, dhe 7.2 të Rregullores zgjedhore nr. 04/2024 Certifikimi i subjekteve politike dhe i kandidatëve të tyre në mënyrë decidive thuhet se *“Subjektet politike, në aplikimin për certifikim, duhet të përfshijë librezat e nënshkrimeve, në formularin i cili është bashkëngjitur, në formë fizike dhe elektronike, Shtojca II – Libreza e nënshkrimeve (në formën fizike dhe elektronike), që përmban: 7.1. njëqind (100) nënshkrime të vlefshme të përkrahjes së votuesve të regjistruar për secilën komunë në të cilën subjekti politik ka për qëllim të garojë. Në rast se ka për qëllim që të garojë në dhjetë ose më shumë komuna, atëherë numri i nënshkrimeve duhet të jetë të paktën njëmijë (1,000) nënshkrime. 7.2. njëmijë (1,000) nënshkrime të vlefshme, nëse ka për qëllim të garojë në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës”*. Ndërsa në nenin 4 të .2 nën paragraf 2 të Rregullores zgjedhore nr. 04/2024 Certifikimi i subjekteve politike dhe i kandidatëve të tyre në mënyrë decidive thuhet se *“2.2 dokumentacioni përcjellës është i plotë dhe se nënshkrimet në librezën e nënshkrimeve janë të vlefshme dhe të mjaftueshme”*.

Andaj Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruar në ankesën e parashtruar, parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj me asnjë provë të vetme se me këto veprime nga ana e KQZ-së, ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”.

Prandaj, nga arsyet e parashtruara më lart dhe në pajtim me nenit 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe nenin 13 paragrafi 2 dhe neni 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6, të Rregullores, së PZAP-it Nr.01/2025, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, si dhe, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e refuzuar ankesën si të pabazuar.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.3/2026 datë 16.05.2026



**Kryesuesi i Panelit,
Bujar Muzaqi**

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzetetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.